



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Orahovac/Municipality of Rahovec
KUVENDI I KOMUNËS/SKUPSTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/85 Nr. i faq./Br.str./No.pg 82

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.04/2012"), nenit 3 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.4, nenit 34 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.1.2026, merr këtë:

V E N D I M

Për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

1. **Miratohet** vendimi për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).
2. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), i cekur në pikën 1 (një) të këtij vendimi, ka këtë përbërje:
 - 2.1. **Smajl Latifi** - Kryetari i Komunës, kryesues;
 - 2.2. **Fazli Morina** - Komandanti i stacionit të policisë;
 - 2.3. **Shani Sylka** - Bashkësia Islame – Rahovec;
 - 2.4. **Shejh Besim Shehu** - Teqeja e madhe e "Shejh Sylejmanit";
 - 2.5. **Sejid Shehu** - Teqeja e "Haxhi Shejh Iliaz Shehut";
 - 2.6. **Millan Stanojeviq** - Kisha ortodokse serbe;
 - 2.7. **Jovan Simic** – Komuniteti serb;
 - 2.8. **Lirigzon Hamza** - Komuniteti egjiptian;
 - 2.9. **Valon Berisha**- Komuniteti Rom;
 - 2.10. **Bujar Morina** - Komuniteti ashkali;
 - 2.11. _____ - Kryesuesi i Komitetit për Komunitete;
 - 2.12. **Alban Gashi** - Zyrtar për barazi gjinore;
 - 2.13. **Muhamet Morina** - Drejtor i Drejtorisë për Arsim;
 - 2.14. **Erseka Cana** - Kryetare e këshillit të prindërve;
 - 2.15. **Toger Vedat Shatri**- Përfaqësues i FSK-së;
 - 2.16. **Enis Berisha** - KLSP;
 - 2.17. **Beqir Hamza** - KEVSB;
 - 2.18. **Irfan Berisha** - Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale;
 - 2.19. **Lendrit Qeli** - ZKKK;
 - 2.20. **Vjollca Gurgule** - Një përfaqësues nga OJQ;
 - 2.21. **Shaip Shala** - Një përfaqësues nga mediat locale;
 - 2.22. **Mustaf Korenica** - përfaqësues nga komuniteti i biznesit;
 - 2.23. **Adelina Vuqiterna** - përfaqësues nga dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara;
 - 2.24. **Skender Hamza** – Koordinator i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) janë:
- 3.1. Përgatitja e planit vjetor të punës dhe zhvillimi i projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi;
 - 3.2. Identifikimi i dukurive negative, që mund të prishin sigurinë publike dhe rekomandojnë planet e veprimt;
 - 3.3. Bashkëpunojnë me policinë për parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi;
 - 3.4. Bashkëpunojnë me institucionet qendrore, që merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti më të sigurt në bashkësi;
 - 3.5. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSBB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi, që i tejkalojnë kufijtë e komunës së tyre;
 - 3.6. Sigurimi i financimit të projekteve nga Kuvendi i Komunës, që kanë të bëjnë me sigurinë në bashkësi;
 - 3.7. Përmes Komunës, kërkon nga ndonjë organizatë joqeveritare financimin e projekteve që lidhen me sigurinë në bashkësi, fton në takimet e tyre përfaqësuesit nga MPB-ja dhe institucione të tjera gjegjëse;
 - 3.8. Kërkon nga policia përgjigje për rastet që janë me rëndësi për sigurinë në bashkësi, duke mos ndërhyrë në procesin e hetimeve policore;
 - 3.9. Mbajtja e takimeve të rregullta, ashtu siç përcaktohet në nenin 11 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.
4. Funksionimi i KKSBB-së, detyrat dhe përgjegjësitë e kryesuesit dhe të anëtarëve të KKSBB-së, përfaqësimi i komuniteteve, mbledhjet, pjesëmarrja në mbledhje, vendimmarrja, zëvendësimi i anëtarëve, dorëheqja, raportimi, mbikëqyrja dhe kompensimi i anëtarëve të KKSBB-së, janë të parapara me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012MPB-03/2012 MAPL.
5. Anëtarët e KKSBB-së kanë mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës.
6. Anëtarët e KKSBB-së do të paguhën nga 50€ (pesëdhjetë euro) për çdo takim të mbajtur nga buxheti i Komunës së Rahovecit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe anëtarët e KKSBB-së.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetari të Komunës,
- Anëtarëve të KKSBB-së,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr. 85/26

Më datë: 26.1.2026

